



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE GJIROKASTËR

NOTER GENCI H. NIKOLLA  
ADRESA SARANDE, LAGJIA NR.1,  
RRUGA " ONHEZMI"  
TEL: 692094054

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 582

Nr. koleksioni: 226

Sarande më 17/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021021910025938382



A2021021910025938382



## LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

(Per Trashegimlensesin Gjergji Barjam Piro)

Sot, më datë 17 Prill 2021 , para meje Noter GENCI H. NIKOLLA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore GJIROKASTËR , me zyrë në adresën SARANDE, LAGJIA NR.1, RRUGA " ONHEZMI", u paraqit personalisht:

**KËRKUESE:** Livia Piro, atësia Gjergji, amësia Rozina, shtetase Shqiptare, lindur në Sarandë dhe banuese në Sarandë, me adresë 27 Qershori; Nd. 421; Sarandë; Gjashtë; 9702; Sarandë, lindur më 21/07/1996, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032496848 dhe nr. personal J65721097R.

**Objekti :** Kerkohet leshimi i Deshmise se Trashegimise Ligjore te Trashegimlensesit Gjergji Barjam Piro.

**Baza Ligjore:** Neni 316, 317, 318, 318/1, 318/2, 320, Neni 348, 360 – 361 te Kodit Civil, Neni 1-7 i Ligjit Nr. 121/2013; Neni 3, 4 i Ligjit Nr. 131/2013; Neni 62/d, 111-113 te Ligjit Nr.110/2018 “ Per Noterine” .

Pasi administrova provat shkresore te paraqitur prej Kerkueses :

V E R E J:

Se pas njohjes me Kerkesen e Livia Piro, per leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore te Trashegimlensesit, babait te saj, Gjergji Barjam Piro dhe pasi kontrollova kopetencen vendore, procedova me shqyrtimin e kesaj Kerkese, bazuar ne Nenin 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 131/2013 dhe Nenin 111-113 te Ligjit Nr. 110/2018 “ Per Noterine” .

Sipas Certifikates se Vdekjes date 14.04.2021, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Sarande provohet se Trashegimlensesi Gjergji Barjam Piro , i datelindjes 30.08.1971, lindur ne Sarande dhe me vendbanim te fundit ( adresa ne daten e vdekjes) ne Gjashte, Bashkia Sarande, shtetas shqiptar, ka vdekur me daten 04.04.2021.

Meqenese Trashegimlensesi vendbanimin e fundit e ka pasur ne Gjashte, ne baze te Nenit 318/1, 348 te Kodit Civil, Deshmia e Trashegimise leshohet nga Noteri i njesise vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit Trashegimlensesi. Pra une Noteri Genci Nikolla, Noter ne Sarande, kam kopetencen Vendore per Leshimin e Deshmise se Trashegimise te TIJ.

Me percaktimin e sakte te dates se vdekjes se Trashegimlensesit, lidhet :

1. Koha e çeljes se trashegimise, 2. Ligji material civil qe do te zbatohet per rregullimin e saj, 3.Rrethi i trashegimtareve qe kane zotesi per te trasheguar.

Duke ju referuar Nenit 318 te Kodit Civil, sipas te cilit: “*Trashegimia çelet ne kohen kur vdes Trashegimlensesi dhe rregullohet sipas ligjit te kohes kur eshte çelur*”, athere ligji material qe do te gjeje zbatim ne shqyrtimin e kesaj kerkese do te jete pikerisht Ligji Nr. 7850 , date 29.07.1994 “ Kodi Civil i Republikes se Shqiperise” , hyre ne fuqi me date 01 Nentor 1994 ( meqenese Trashegimlensesi Gjergji Barjam Piro ka vdekur me daten 04.04.2021).



A2021021910025938382

Ne baze te nenit 317 te Kodit Civil : *“Trashegimia me ligj ka vend kur trashegimlensesi nuk ka bere testament ose ka bere vetem per nje pjese te pasurise se tij, ose kur testamenti eshte teresisht a pjeserisht i pavlefshem ”.*

Pas marrjes se pergjigjes prej Dhomes Kombetare te Notereve, date 16.04.2021, nuk rezulton qe Trashegimlensesi Gjergji Barjam Piro , te kishte disponuar me Testament per fatin e pasurise se tij per kohen pas vdekjes, prandaj ka vend zbatimi i trashegimise ligjore.

Kerkuesja Livia Piro, vajza e Trashegimlensesit, per leshimin e Deshmise paraqiti dokumentat si me poshte vijon ( te cilat administrohen ne Deshmine Originale qe mbahet ne Arkiven Noteriale) :

1. Certifikate Vdekje per Trashegimlensesin Gjergji Barjam Piro, date 14.04.2021 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Sarande
2. Certifikate Familjare, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Sarande, ne daten 14.04.2021 (perberja familjare ne daten 03.04.2021, pra nje dite para vdekjes).
3. Certifikate Martese e Rozina Piro, leshuar nga ZGJC rrethi Sarande date 14.04.2021( bashkeshortja e Trashegimlensesit).

Ne reference te Nenit 361/1 te Kodit Civil : *“ Ne radhe te pare thirren ne trashegim femijet dhe bashkeshorti i afte apo i pa afte per pune, duke trasheguar secili ne pjese te barabarta “.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mesiperm te paraqitur prej Kerkuesit, rezulton se me vdekjen e tij, Trashegimlensesi Gjergji Barjam Piro , ka lene pas bashkeshorten e tij Rozina Selfo Piro dhe femijet e tij Livia Gjergji Piro dhe Ridgers Gjergji Piro, te cilet thirren ne trashegim si Trashegimtare ligjore te radhes se pare te Trashegimlensesit, duke trasheguar secili nga 1/3 pjese te barabarta te pasurise trashegimore te tij .

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se te thirrurit ne trashegim te siper cituar, ne baze te Nenit 320 te Kodit Civil, kane zotesi per te trasheguar, sepse kane qene gjalle ne kohen e celjes se trashegimise ( qe perkon me daten e vdekjes se Trashegimlensesit).

Njekohesisht nuk rezulton qe ndonjeri prej tyre te kishte hequr dore nga trashegimia apo te ishte bere i padenje per te trasheguar, si dhe nuk rezulton gjithashtu qe Trashegimlensesi te kishte femije te tjere jashte martese, nga ndonje martese tjeter te meparshme , apo te kishte femije te biresuar.

Ne perfundim une Noteri konkludoj se Kerkesa duhet pranuar .

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Nenin 316, 317, 318, 318/1, 318/2, 320, Neni 348, 360 – 361 te Kodit Civil, Neni 1-7 i Ligjit Nr. 121/2013; Neni 3, 4 i Ligjit Nr. 131/2013; Neni 62/d, 111-113 te Ligjit Nr.110/2018 “ Per Noterine” :

**V E N D O S A**

Pranimin e Kerkeses se Kerkueses Livia Piro.

**Leshimin e Deshmise se Trashegimise ligjore per Trashegimlensesin Gjergji Barjam Piro, vdekur me daten 04.04.2021.**



A2021021910025938382

**Caktimin Trashëgimtare Ligjore te radhes se pare te Trashëgimlënesit Gjergji Barjam Piro , bashkeshorten e tij Rozina Selfo Piro dhe femijet e tij Livia Gjergji Piro dhe Ridgers Gjergji Piro , te cilet trashëgojne nga 1/3 pjese e barabarta te pasurise trashëgimore te Trashëgimlënesit.**

Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasqetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika 2 e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”.

Gjithashtu nëse trashëgimlënësi, është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese.

*Kërkuesi mori dijëni dhe u sqarua nga Noteri per detyrimin ligjor për depozitimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ( ASHK Drejtoria Vendore Sarande), brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”. Shpenzimet Noteriale jane ne ngarkim te kërkuesit.*

*Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet dhe lëshohet ne tre njesi origjinalë.*

*Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.*

*Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në datën 17 Prill 2021, në orën 11.30

## NOTER

Genci Nikolla

